

Akti i Themelimit i/
Act of Incorporation of

“**BALTIC TEXTILE TRADING**”

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar/
Limited liability company

Aprovuar nga Ortaku i Vetëm

më datë 18 / 04 / 2025



AKTI I THEMELIMIT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR	ACT OF INCORPORATION OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY
“Baltic Textile Trading” SHPK	
Ortaku i Vetëm i shoqërisë “Baltic Textile Trading” SHPK: - Humana Second Hand Fundraising Projects, një subjekt juridik Lituanëz, organizatë jo-fitimprurëse me përgjegjësi të kufizuar civile, e regjistruar rregullisht pranë Qendrës së Regjistrimit me kod 300648904, me adresë në Kibirksties g.6, LT-02242 Vilnius, Lituani (këtu e më tej referuar si “Ortaku i Vetëm”), miratoi këtë Akt Themelimi si më poshtë: THEMELIMI Neni 1 1.1 Ortaku i Vetëm miraton themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Baltic Textile Trading” SHPK (këtu e më tej referuar si “Shoqëria”), në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në veçanti me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i përditësuar (këtu e më tej “Ligji për Shoqëritë Tregtare”). 1.2 Selia e Shoqërisë është në adresën: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Kullat Binjake, Qendra Tregtare, Kati 2, Nr. 24, 1019, Tiranë, Shqipëri. 1.3 Shoqëria themelohet për një kohëzgjatje të pakufizuar. OBJEKTI	The Sole Partner of the company “Baltic Textile Trading” SHPK: - Humana Second Hand Fundraising Projects, a Lithuanian non-profit public legal entity of limited civil liability, duly registered with the Centre of Registers under code 300648904, with its address at Kibirksties g.6, LT-02242 Vilnius, Lithuania (hereinafter referred to as the “Sole Partner”), approved the present Act of Incorporation as follows: INCORPORATION Article 1 1.1 The Sole Partner approves the incorporation of the limited liability company “Baltic Textile Trading” SHPK (hereinafter referred to as the “Company”), in accordance with the legislation in force and in particular with Law No. 9901 dated 14.04.2008 “On entrepreneurs and commercial companies”, as amended (hereinafter referred to as the “Company Law”). 1.2 The headquarters of the Company is at the address: Bulevardi Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Trade Center, Floor 2, No. 24, 1019, Tirana, Albania.. 1.3 The Company is established for an unlimited duration. SCOPE



Neni 2

2.1 Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj kryesore në fushën e tregtimit të produkteve tekstile dhe objekti i saj parësor përfshin, por nuk kufizohet në:

- (a) Importi - eksporti, shitja me shumice dhe pakice e produkteve tekstile, veshje të gjitha llojeve;
- (b) Operimi i dyqaneve të shitjeve fizikisht dhe online, për veshje (femra, meshkuj, fëmijë etj.), aksesore, çantë, këpucë, bizhuteri, kozmetike si dhe çdo produkt tjetër;
- (c) Marketingu Digjital dhe Reklamimi: Shoqëria do të ofrojë shërbime të marketingut digjital, duke përfshirë optimizimin e motorëve të kërkimit (SEO), marketingun e mediave sociale, marketingun me *email*, reklamimin *online* dhe aktivitete të tjera promovuese për të rritur dukshmërinë dhe shitjet e produkteve të saj;
- (d) Shërbimet e Logjistikës dhe Përbushjes: Shoqëria do të menaxhojë shërbimet e logjistikës, magazinimit, përbushjes së porosive dhe shpërndarjes për të lehtësuar shpërndarjen efikase të produkteve tek klientët;
- (e) Shërbimet e Mbështetjes së Klientit: Shoqëria do të ofrojë mbështetje për klientët, duke përfshirë pyetjet, ankesat, kthimet dhe shkëmbimet, për të siguruar kënaqësinë dhe mbajtjen e klientit;
- (f) Zhvillimi dhe Mirëmbajtja e Teknologjisë: Shoqëria do të zhvillojë, mirëmbajë dhe përmirësojë platformat e saj *online*, duke përfshirë faqet e internetit, aplikacionet celulare dhe infrastrukturën tjetër digjitale të nevojshme për kryerjen e tregtimit në internet;
- (g) Shërbimet Ndihmëse: Shoqëria do të angazhohet në çdo aktivitet, shërbim ose veprimtari tjetër që është e rastësishme ose e favorshme për arritjen e objektivave të mësipërm, duke përfshirë partneritetet, bashkëpunimet dhe investimet në lidhje

Article 2

2.1 The Company exercises its main activity in the field of trading textile products and its primary object includes but is not limited to:

- (a) Import - export, wholesale and retail of textile products, clothing of all kinds.
- (b) Operation of physical and online stores, for clothing (women, men, children, etc.), accessories, bags, shoes, jewelry, cosmetics and any other product;
- (c) Digital Marketing and Advertising: The company shall provide digital marketing services, including search engine optimization (SEO), social media marketing, email marketing, online advertising, and other promotional activities to enhance the visibility and sales of its products;
- (d) Logistics and Fulfillment Services: The company shall manage logistics, warehousing, order fulfillment, and delivery services to facilitate the efficient distribution of products to customers;
- (e) Customer Support Services: The company shall offer customer support, including inquiries, complaints, returns, and exchanges, to ensure customer satisfaction and retention;
- (f) Technology Development and Maintenance: The company shall develop, maintain, and upgrade its online platforms, including websites, mobile apps, and other digital infrastructure necessary for the conduct of online trading;
- (g) Ancillary Services: The company shall engage in any other activities, services, or operations that are incidental or conducive to achieving the above objectives including partnerships, collaborations, and investments related to the trade of products;



me tregtinë e produkteve;

- 2.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari dhe aktivitet tjetër që lidhet direkt ose indirekt me objektin e saj, në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj.
- 2.3 Përveç objektit kryesor të veprimtarisë së saj, Shoqëria mund të kryejë edhe çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga legjislacioni në fuqi.

STATUTI

Neni 3

Ortakët deklarojnë miratimin e Statutit të Shoqërisë.

KAPITALI

Neni 4

- 4.1 Kapitali i regjistruar dhe tërësisht i paguar i Shoqërisë është 100 ALL (njëqind lekë), i cili përbën 1 (një) kuotë, në pronësi të Ortakut të Vetëm, si më poshtë vijon:
- **Humana Second Hand Fundraising Projects**, një subjekt juridik Lituanëz, organizatë jo-fitimprurëse me përgjegjësi të kufizuar civile, e regjistruar rregullisht pranë Qendrës së Regjistrimit me kod 300648904, me adresë në Kibirksties g.6, LT-02242 Vilnius, Lituanë, zotëruar nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100 ALL (njëqind lekë) e cila përfaqëson 100 (njëqind) % të kapitalit të Shoqërisë.
- 4.2 Ortakët i Vetëm nuk përgjigjen për detyrimet e Shoqërisë dhe mbulon personalisht humbjet e Shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

ORGANET E SHOQËRISË

Neni 5

- 5.1 Organet e Shoqërisë janë si më poshtë:
- (a) Asambleja e Përgjithshme;

- 2.2 In accordance with the legislation in force, the Company may carry out any activity that is directly or indirectly related to its object, in the Republic of Albania and abroad.

- 2.4 In addition to the primary object of its activity, the Company may also carry out any other business activity which is not prohibited by the legislation in force.

ARTICLES OF ASSOCIATION

Article 3

The Partners declare the approval of the Articles of Association of the Company.

SHARE CAPITAL

Article 4

- 4.1 The registered and fully paid capital of the Company is 100 ALL (one hundred lek), which constitutes 1 (one) share, owned by the Sole Partner of the Company, as follows:
- **Humana Second Hand Fundraising Projects**, a Lithuanian non-profit public legal entity of limited civil liability, duly registered with the Centre of Registers under code 300648904, with its address at Kibirksties g.6, LT-02242 Vilnius, Lithuania, owner of 1 (one) share, with a nominal value of 100 (one hundred lek), which represents 100 (one hundred) % of the Company's capital.
- 4.2 The Sole Partner is not responsible for the obligations of the Company and personally covers the losses of the Company up to the outstanding part of the subscribed contributions.

BODIES OF THE COMPANY

Article 5

- 5.1 The bodies of the Company are as follows:
- (a) the General Assembly;

(b) Administratori.

Neni 6

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë.
- 6.2 Të drejtat e Asamblesë së Përgjithshme ushtrohen nga Ortaku i Vetëm.
- 6.3 Asambleja e Përgjithshme ushtron kompetencat e saj për të miratuar vendime në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 7

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme për një mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 7.2 Administratori i parë i Shoqërisë është:
- Znj. Anca-Maria IANCU.
- 7.3 Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe përfaqëson Shoqërinë në marrëdhënie me të tretët.
- 7.4 Administratori është përgjegjës për aktivitetin e zakonshëm tregtar të Shoqërisë dhe ushtron kompetencat e tij në përputhje me Statutin e Shoqërisë dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.
- 7.5 Në rast se Shoqëria emëron më shumë se një administrator, Shoqëria mund të përfaqësohet nga secili prej tyre individualisht, përmes një nënshkrimi të vetëm. Megjithatë, Shoqëria mund të vendosë rregulla të tjera përfaqësimi për administratorët, të cilat miratohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, të cilat do t'u njoftohen administratorëve dhe do të regjistrohen në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

TË NDRYSHME

Neni 8

Ky Akt Themelimi është hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze. Në rast mospërputhjesh mes të dy gjuhëve, do të mbizotërojë versioni shqip.

(b) the Administrator.

Article 6

- 6.1 The General Assembly is the supreme decision-making body of the Company.
- 6.2 The rights of the General Assembly are exercised by the Sole Partner.
- 6.3 The General Assembly exercises its powers to adopt resolutions in accordance with the Articles of Association of the Company and the Company Law.

Article 7

- 7.1 The Company is managed by one or more administrators, who are appointed by the General Assembly for a term of 5 (five) years, with the right to re-election.
- 7.2 The first Administrator of the Company is:
- Ms. Anca-Maria IANCU.
- 7.3 The administrator is the legal representative of the Company and represents the Company in relations with third parties.
- 7.4 The administrator is responsible for the usual commercial activity of the Company and exercises its powers in accordance with the Articles of Association of the Company and the Company Law.
- 7.5 In case the Company appoints more than one administrator, the Company may be represented by each of them individually, through a single signature. However, the Company may establish other representation rules for the administrators, which are approved by resolution of the General Assembly, which shall be notified to the administrators and registered with the Commercial Register of the National Business Centre.

MISCELLANEOUS

Article 8

The present Act of Incorporation has been drawn up in Albanian and English. In case of discrepancies between the two languages, the Albanian version will prevail.



Neni 9	Article 9
Të gjitha çështjet që nuk parashikohen shprehimisht në këtë Akt Themelimi do të rregullohen nga dispozitat e Statutit dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare, si dhe nga dispozitat e legjislacionit në fuqi.	All the matters not expressly foreseen in the present Act of Incorporation shall be governed by the provisions of the Articles of Association and the Company Law, as well as by the provisions of the legislation in force.
Nënshkruar nga Ortaku i Vetëm:/Signed by the Sole Partner: “Humana Second Hand Fundraising Projects” Përfaqësuar nga:/Represented by: Drejtori i Përgjithshëm / General Director Mr. Orjan Rolf Erik Osterdal   <i>Orjan Osterdal</i>	